

V E N D I M

Nr.312, datë 30.4.1996

PËR SHTRIRJEN E EFEKTEVE TË KONTRATËS KOLEKTIVE

Në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Palët kontraktuese mund t’i drejtojnë, së bashku ose veçmas, një kërkesë me shkrim ministrit të Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, në të cilin kërkohet shtrirja e fushës së zbatimit të kontratës kolektive ku ato janë palë ndaj punëdhënësve dhe punëmarrësve që i përkasin degës së ekonomisë a profesionit të përcaktuar dhe që nuk janë të lidhur nga kjo kontratë.

2. Kërkesa për shtrirjen e efekteve duhet të përmbajë në aneks dispozitat e kontratës kolektive, të cilave ajo do t’i shtrijë efektet.

Për më tepër ajo duhet të përmbajë dispozita të qarta për fushën e saj të zbatimit territorial, profesional a të ndërmarrjeve, datën e hyrjes në fuqi, si dhe kohëzgjatjen e vlefshmërisë së saj; ajo duhet të përmbajë gjithashtu informacionet e nevojshme, në mënyrë që autoritetet të mund të kontrollojnë nëse kushtet e vëna nga pika 4 e këtij vendimi janë plotësuar.

Në qoftë se kërkesa nuk është paraqitur në formën e duhur (me shkrim) apo nuk jep të dhënat e duhura, procedura pezullohet dhe kërkesa nuk merret parasysh, nëse palët nuk marrin masat e duhura në një afat të caktuar nga ministri.

Kërkesa për shtrirjen e efekteve duhet të publikohet në një gazetë lokale nga ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.

Ministri ka të drejtë të mos botojë kërkesën, nëse kushtet e kërkuara për shtrirjen e efekteve nuk janë në mënyrë të dukshme të plotësuar.

3. Afati i kundërshtimit prej 30 ditësh fillon që nga momenti i publikimit të kërkesës së shtrirjeve të efekteve.

Gjatë këtij afati çdo punëdhënës i interesuar mund ta kundërshtojë kërkesën për shtrirjen e efekteve nëpërmjet një kërkesë të motivuar me shkrim që i drejtohet ministrit të Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.

Ministri duhet t'i japë mundësi palëve kontraktuese të shprehin opinionet e tyre me shkrim mbi kundërshtimin, si dhe mbi mendimet e vërejtjet e autoriteteve lokale apo të shërbimeve të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë.

Procedura e kundërshtimit është falas.

4. Shtrirja e efekteve të kontratës kolektive nuk mund të bëhet, veçse kur janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) Punëdhënësit e lidhur nga kontrata kolektive duhet të punësojnë shumicën absolute të të gjithë punonjësve, ndaj të cilëve do të shtrihen efektet e kontratës kolektive.

b) Punëdhënësit që nuk janë të lidhur nga kontrata kolektive duhet të kenë mundësi të bëhen anëtarë të organizatës profesionale kontraktuese; po kështu edhe organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve që nuk janë të lidhura nga kontrata kolektive, duhet ta kenë këtë mundësi për të aderuar në organizatat kontraktuese me të njëjtat të drejta e detyrime si këto të fundit, kur ato ofrojnë garanci të mjaftueshme për respektimin e kontratës.

5. Ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë verifikon plotësimin e kushteve të pikës 4 dhe vendos mbi kërkesën e shtrirjes së efekteve.

Vendimi i tij u njoftohet me shkrim palëve.

Vendimi i shtrirjes, si dhe dispozitat ndaj të cilave ai zbatohet, duhet të publikohen.

6. Palët kontraktuese janë të detyruara të trajtojnë në të njëjtën mënyrë punëdhënësit dhe punëmarrësit e lidhur fillimisht nga kontrata me ata, ndaj të cilëve efektet e kontratës janë shtrirë.

7. Dispozitat e kontratës kolektive të shtrirë zbatohen në vend të atyre të kontratave të lidhura më parë, me përjashtim të rregullave më të favorshme për punëmarrësit.

8. Ministri që është kompetent për të shpallur vendimin për shtrirjen e efekteve, duhet ta shfuqizojë këtë vendim, nëse të gjitha palët e kërkojnë një gjë të tillë.

Ministri që shpall vendimin e shtrirjes së efekteve duhet ta shfuqizojë atë, nëse ai e konstaton vetë apo në rast denoncimi, që kushtet e kërkuara për shtrirjen e efekteve nuk janë më të plotësuar. Ministri kompetent mund ta shfuqizojë vendimin edhe në rast shkeljeje të parimit të barazisë së trajtimit të përmendur në pikën 6.

9. Palët janë të detyruara të njoftojnë menjëherë dhe me shkrim ministrin, në rast zgjidhjeje apo modifikimi të kontratës kolektive.

Kur kontrata kolektive është ndryshuar apo merr fund në një datë përpara se vendimi për shtrirjen e efekteve të ketë pushuar së pasuri efekt, vendimi duhet të zbatohet deri në këtë datë.

Nëse palët nuk njoftojnë në kohë një modifikim apo zgjidhjen e kontratës kolektive, atëherë dispozitat e shtrirja vazhdojnë të jenë në fuqi, derisa vendimi për shtrirjen e efekteve të mos jetë shfuqizuar.

10. Rregullat e këtij vendimi zbatohen në rast modifikimi të dispozitave të shtrira, në rast shtrirjeje të efekteve të dispozitave të reja, në rast zgjatjeje kohore të vendimit të shtrirjes së efekteve, si dhe në rast shfuqizimi të pjesshëm të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.